



**Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Bujqësisë**

**Kriteret për aplikim dhe udhëzuesi për aplikuesit për
grante për zhvillim rural dhe zhvillim të bujqësisë në
komunën e Prishtinës
(Gusht 2019)**



1. Tabela e përmbajtjes

1. Tabela e përmbajtjes	2
2. Përmbledhja e shkurtër e programit për grante për zhvillim rural dhe bujqësi në komunën në Prishtinë.....	3
3. Objektivi i programit	3
4. Kriteret për kualifikim të aplikuesve dhe dokumentet përcjellëse që duhet të dorëzohen së bashku me aplikacion.....	3
Kriteret shtesë vetëm për aplikuesit e përzgjedhur:	5
5. Aktivitetet e pranueshme për financim dhe vlera e ftesës për propozime	5
6. Veprimtaritë dhe kostot e papranueshme për financim	7
7. Si të aplikohet dhe afatet e dorëzimit?.....	8
7.1 Propozimi	8
7.2 Vlerësimi i propozimeve	8
7.3 Kriteret e përzgjedhjes	9
7.4 Ku dhe si të dërgohen formularët	13
8. Menaxhimi i grantit:.....	14



2. Përmbledhja e shkurtër e programit për grante për zhvillim rural dhe bujqësi në komunën në Prishtinë

Komuna e Prishtinës në linjë me strategjinë komunale për zhvillim, që nga viti 2015 ka rritur përpjekjet e saja për t'a përkrahur zhvillimin ekonomik në zonat rurale përmes një fokusi të veçantë në zhvillimin e bujqësisë. Agjensioni Austriak për Zhvillim (ADA) dhe komuna e Prishtinës në vjeshtën e vitit 2015 kanë nënshkruar marrëveshjen për ko-financimin e projektit për zhvillimin përfshirës dhe të qëndrueshëm ekonomik rural në komunat e synuara. Kontributi financiar i komunës së Prishtinës do të shfrytëzohet vetëm për përkrahjen e iniciativave për qëndrueshmëri ekonomike rurale në komunën e Prishtinës. Kjo ftesë për propozime është si vazhdimësi e projektit për zhvillimin përfshirës dhe të qëndrueshëm ekonomik rural në komunën e Prishtinës.

Komuna e Prishtinës synon promovimin e konkurrueshmërisë së fermerëve, prodhuesve bujqësor dhe të kompanive të përpunimit të ushqimit, në rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës rural, krijimin e vendeve të punës dhe gjenerimin e të ardhurave në komunën e Prishtinës. Për të arritur rezultate të qëndrueshme të projektit, është e domosdoshme që të mundësohen forma të reja të prodhimit bujqësor dhe të teknologjive të reja për të rritur produktivitetin, stabilitetin, dhe qëndrueshmërinë e sistemeve të prodhimit me qëllime përtej asaj të vetëm rritjes së rendimenteve, por përfshirë edhe kursimin e ujit dhe të energjisë, reduktimin e rreziqeve, përmirësimin e cilësisë së produkteve, mbrojtjen e mjedisit dhe kontributin në zbutjen e ndryshimeve klimatike.

3. Objektivi i programit

Objektivi i përgjithshëm i kësaj ftese për propozime është përmirësimi/rritja dhe diversifikimi i prodhimit primar bujqësor, zgjerimi apo krijimi i kapaciteteve të ndërmarrjeve agro-ushqimore për përpunimin, ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore, si dhe promovimi i zinxhirit të vlerave bujqësore në komunën e Prishtinës. Përmes kësaj ftese për propozime synohet krijimi i vendeve të reja të punës dhe ruajtja e tyre përmes komercializimit të mëtutjeshëm fermave bujqësore dhe zhvillimit të sektorit agro-ushqimor në zonat rurale të komunës së Prishtinës.

4. Kriteret për kualifikim të aplikuesve dhe dokumentet përcjellëse që duhet të dorëzohen së bashku me aplikacion

Të gjithë **aplikuesit të cilët nuk sjellin dokumentet e kërkuara** si më poshtë për të dëshmuar përputhshmërinë me kriteret për aplikim, **DO TË REFUZOHEN dhe nuk do të vlerësohen aplikacionet e tyre.**

- Aplikuesit duhet të jenë banorë të komunës së Prishtinës dhe investimet duhet të bëhen vetëm brenda territorit të komunës së Prishtinës. **Të dorëzohet një kopje e letërnjoftimit dhe certifikata e vendbanimit, si dhe certifikata e bashkësisë familjare për aplikuesit si persona fizik. Ndërsa për ndërrmarjet të dorëzohet certifikata e biznesit.**
- Aplikuesit si persona fizik duhet të janë mbi moshën 18 vjeçare dhe jo më të vjetër se 61 vjeç. Në rastin e ndërrmarjeve ky kriter nuk aplikohet.



- Aplikuesit duhet t'i kenë të shlyera të gjitha detyrimet tatimore, siç janë: taksat komunale dhe tatimin në pronë. Ndërsa për ndërrmarrjet t'i kenë të shlyera të gjitha tatimet të aplikueshme për ndërrmarrje në Kosovë. **Të dorëzohet dëshmia e pagesës së taksave komunale dhe tatimit në pronë, kjo vlenë për aplikuesit fizik. Për ndërrmarrjet, dëshminë që nuk kanë obligime financiare ndaj Administratës Tatimore në Kosovë.**
- Aplikues të papranueshëm janë përfituesit e granteve nga komuna e Prishtinës ose donatorët e tjerë në Kosovë brenda vitit fiskal. **Vetëm nga aplikuesit e përzgjedhur do të kërkohet të dorëzojnë dëshmi se aplikuesi nuk është përfitues i granteve nga qeveria qendrore për këtë fushë brenda këtij viti fiskal.**

Aplikuesit dhe anëtarët e tyre të familjes që jetojnë brenda një bashkësie familjare të cilët kanë përfituar grante nga komuna e Prishtinës apo donatorët e tjerë përgjatë dy (2) viteve të fundit, mund të aplikojnë vetëm për financim prej maksimalisht 50% të vlerës së gjithëmbarshme të projektit të propozuar, ku pjesa tjetër duhet të financohet nga aplikuesi.

- Përqindja e financimit për aplikues si persona fizik nuk mund të jetë më shumë se **80 % e vlerës së përgjithshme të projektit të propozuar**. Ndërsa për ndërrmarrjet, përqindja e financimit për aplikues nuk mund të jetë më shumë se **70 % e vlerës së përgjithshme të projektit të propozuar**.

Për më tepër, aplikuesit e pranueshëm i përkasin njëres prej kategorive të mëposhtme:

- Fermerë të regjistruar që posedojnë numrin identifikues të fermerit. **Të dorëzohet një kopje e numrit të identifikimit të fermës.**
- Shoqata ose kooperativa të fermerëve. Shoqata të prodhuesve të regjistruar. **Të dorëzohet një kopje e çertifikatës së regjistrimit dhe kopje e statutit.**
- Ndërrmarrjet për përpunimin e produkteve bujqësore me së paku një vit përvojë të dëshmuar për përpunimin e produkteve bujqësore. **Të dorëzohet një kopje e çertifikatës së regjistrimit dhe dëshmi për qarkullimin financiar të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.**
- Fermerët që **posedojnë së paku 3 deri në 10 lopë qumështore** të regjistruara me matrikuj të Republikës së Kosovës në kohën e aplikimit e të cilat dëshirojnë të aplikojnë për përmirësimin e kushteve të stallave si dhe së **paku 5 lopë qumështore për ndërtimin e dhomës së qumështit.**
- Fermerët të cilët posedojnë tufë të vogël të bagëtisë e që synojnë të përmirësojnë kushtet e stallave **së paku 10 deri në 30 bagëti të vogla në kohën e aplikimit.**
- Fermerët dhe/ose bletaret të cilat posedojnë minimalisht **5 dhe maksimalisht 20 koshere** në kohën e aplikimit;
- Prodhuesit e **perimeve në fushë të hapur, dhe bimëve mjekësore/aromatike** me një sipërfaqe minimalisht **prej 0,1 Ha në kohën e aplikimit;**



**Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Bujqësisë**

- Kultivuesit e **pemëve drufrutore dhe manore** të cilët aplikojnë për zgjerim të kapacitetit prodhues **duhet të kenë minimalisht 0,1 Ha sipërfaqe** të kultivuar me pemë në kohën e aplikimit;

Aplikuesit fillestar për LOT 1, 2 dhe 3 pasiqë të përzgjedhen si përfitues të potencial duhet të dorëzojnë një biznes plan sipas formatit që do të jetë në dizpozicion nga Drejtoria e Bujqësisë, komuna e Prishtinës.

Kriteret shtesë vetëm për aplikuesit e përzgjedhur:

- Aplikuesit e përzgjedhur për secilën fushë të përmendur më lartë duhet të ofrojnë dokumente të pronësisë së tokës/arave të cilat planifikohen të mbillen, ose të ofrojnë kontrata të qirasë me periudhë minimale dhjetë vite nga data e para-përzgjedhjes për dhënien e grantit nga projekti. Aplikuesit që planifikojnë ndërtim duhet të dorëzojnë lejet e ndërtimit pas përzgjedhjes së projektit.
- Për projektet për zgjerimin e prodhimit në pemishte në komunën e Prishtinës, aplikuesit do t'i kërkohet që të ofrojnë një analizë fizike dhe kimike të dheut në para nënshkrimit të kontratës në fazën e zbatimit të grantit të projektit. Në rast se analizat fizike kimike të dheut nuk janë në përputhje me kulturën bujqësore që aplikuesi ka planifikuar t'a mbjell me grantin e kërkuar, atëherë kjo do të konsiderohet si bazë e fuqishme për refuzimin e projektit. Përveç kësaj, do të rimbursohen vetëm fidanët e certifikuar.
- Aplikuesit nuk duhet të kanë borxhe ndaj instucioneve publike dhe kredi me performance jo të mirë ndaj bankave komerciale.

5. Aktivitetet e pranueshme për financim dhe vlera e ftesës për propozime

Kohëzgjatja për implementimin e aktiviteteve të pranueshme për financim nuk mund të jetë më shumë se 3 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës me komunën e Prishtinës.

Nëse përfituesi i përzgjedhur nuk mund të përmbushë siç duhet në afat prej një (1) muaj të gjitha kërkesat ligjore të cilat mund të parashtrohen nga komuna e Prishtinës dhe kushtet për implementimin e projektit të propozuar siç janë por nuk do të limitohen në leje ndërtimore, pëlqime mjedisore dhe licensime të tjera për siguri ushqimore, komuna e Prishtinës mund të pezullojë ose të shkëpusë kontratën në mënyrë të njëanshme në lidhje me projektin e përzgjedhur.

Shuma e përgjithshme në dispozicion për këtë thirrje për propozim është 375,000.00 Euro. Kjo vlerë ndahet në disa LOTE si më poshtë

LOT 1: Grantet për përmirësimin, rritjen apo diversifikimin e prodhimit primar bujqësor me shumë të përgjithshme në dispozicion prej **200,000.00 Euro.**



Vlera minimale për aplikim 7,500 Euro, ndërsa vlera maksimale 15,000 Euro.

Nësektoret e sygjieruar: Pemët dhe perimet, blegtoria, bletaria dhe shpezëtaria.

Investimet e parashikuara mund të lidhen me marketingun direkt në fermë, zhvillimin e produkteve bujqësore dhe modernizimin dhe komercializimin e mëtutjeshëm të fermave bujqësore në komunën e Prishtinës.

Aktivitetet e pranueshme për financim:

- Përmirësimin gradual të fermave bujqësore përmes përmirësimit të infrastrukturës së prodhimit bujqësor, me qëllim të rritjes dhe përmirësimit të prodhimit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore. Përbushjen e standardeve për sigurinë ushqimore dhe cilësinë, mirëqenien e kafshëve, shëndetin e kafshëve dhe bimëve.
- Projektet që ofrojnë perspektiva të punësimit edhe për fermerë të vegjël, me theks të veçantë në mbështetjen e grave, të rinjve, si dhe të personave me nevoja të veçanta të cilët janë të angazhuar në bujqësi dhe zhvillim rural;
- Futja e teknikave dhe praktikave moderne të mbarështimit të bagëtisë dhe të kultivimit të kulturave bujqësore, duke përfshirë eksperimentimin me kultivarë dhe hibride të reja të kulturave bujqësore.
- Projektet që nxisin inovacionin dhe zhvillimin e produkteve të reja, duke shtuar vlerën, bashkëpunimet për të shfrytëzuar tregjet e reja dhe për të shkurtuar zinxhirin e furnizimit ushqimorë duke i lidhur prodhuesit me përpunuesit.
- Përmirësimi i prodhimit të perimeve përmes prodhimit të fidaneve cilësore të perimeve.
- **Projektet për përmirësimin e mekanizmit bujqësor mund të aplikojnë vetëm për financimin e 50% të vlerës së tyre.**
- Vetëm paisje të reja financohen nga komuna e Prishtinës të prodhuara në dy vitet e fundit.

LOT 2: Zgjerimin apo krijimin e kapaciteteve të ndërmarrjeve agro-ushqimore për përpunimin, ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore, si dhe promovimin e zinxhirit të vlerave bujqësore në komunën e Prishtinës me shumë të përgjithshme në dispozicion prej **100,000 Euro.**

Vlera minimale për aplikim 15,000 Euro, ndërsa vlera maksimale 25,000 Euro.

Nësektoret e sygjieruar: Prodhimi i mishit, prodhimi i qumështit, produktet pyjore jo drusore dhe pemët dhe perimet.

Aktivitetet e pranueshme për financim:



**Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Bujqësisë**

- Përmirësimin e performancës së përgjithshme dhe konkurrencën e prodhimit të produkteve primare bujqësore përmes përpunimit të tyre dhe përmirësimit të marketingut.
- Projektet që promovojnë bashkëpunimin në zinxhirin ushqimor ndërmjet prodhuesve primar të industrisë bujqësore, industrisë së përpunimit dhe palëve të treta.
- Projektet që mbështesin zhvillimin dhe zgjerimin e qasjes integruese në komunat e synuara, të cilat do të mbështesnin rritjen ekzistuese dhe potencialin e nën-sektorëve në komunën e Prishtinës, si të: produkteve pyjore jo-drusore, industrisë së përpunimit të mishit, industrisë së qumështit, qendrave të përpunimit të frutave dhe perimeve dhe qendrave për grumbullimin e frutave dhe perimeve.
- Përmirësimi i magazinimit të produkteve të gatshme.
- Përmirësimi i paketimit të produkteve të gatshme.
- Promovimi i produkteve të reja të përpunuara.
- Projektet që kontribuojnë në përmbushjen e standardeve për sigurinë ushqimore dhe cilësinë e tyre.

LOT 3: Grante për zhvillimin e aktiviteteve rurale dhe diversifikimin e produkteve në fermat bujqësore në komunën e Prishtinës me shumë të përgjithshme në dispozicion prej **75,000 Euro**.

Vlera minimale për aplikim 7,500 Euro, ndërsa vlera maksimale 15,000 Euro.

Aktivitetet e pranueshme për financim:

- Diversifikimi dhe zhvillimi i aktiviteteve rurale nëpërmjet mbështetjes për investime në diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e aktiviteteve jobujqësore.
- Projektet për promovim të agro turizmit në komunën e Prishtinës, përmes **por jo të limituar vetëm në rehabilitimin e mullinjëve të vjetër apo objekteve të vjetra që mund të shfrytëzohen për promovimin e kësaj fushe.**
- Projektet për promovimin e përpunimit në fermë të produkteve bujqësore dhe marketingut direkt.
- Projektet për prodhimin e produkteve tradicionale.
- Merren parasysh edhe çështjet e ndërlidhura siç janë barazia gjinore (përfshirja e grave fermere kanë përparësi) dhe mbrojtja dhe menaxhimi i mjedisit;

6. Veprimtaritë dhe kostot e papranueshme për financim

- Materialet harxhuese, si farërat dhe plehrat pa ndonjë koncept themelor.
- Kërkesat për lopë qumështore apo bagëti të tjera, pa shpjegim të duhur të kthimit të investimeve (ROI), si dhe për përfitime të tjera relevante.
- Therrtoret e brojlerëve.
- Therrtoret e bagëtive të imëta.
- Ndërtimi i serrave për kultivimin e perimeve ose dredhëzave jashtësezonale.
- Shpenzimet e shkaktuara para se të jepet granti ose pas përfundimit të kontratës.
- Shpenzimet për stafin dhe personelin tjetër.



- Shpenzimet e zakonshme operative (si shpenzimet për materialet harxhuese, të mirëmbajtjes dhe të ngjashme).

7. Si të aplikohet dhe afatet e dorëzimit?

7.1 Propozimi

Aplikuesit duhet të dorëzojnë propozimin, me një përshkrim të projektit ideor. Aplikuesit mund të aplikojnë në gjuhën shqipe, duke përdorur formularin që mund të shkarkohet nga faqja e internetit (webfaqja). Aplikimet e shkruara me dorë nuk do të pranohen.

Raundi i financimit	Afati për dorëzimin e propozimeve	Vlerësimi
Thirrja për propozime për zhvillim rural dhe zhvillim të bujqësisë në komunën e Prishtinës	Thirrja për propozime do të jetë e hapur prej 20 Gusht 2019 . <u>Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve, 20 Shtator 2019, 15h00.</u>	Vlersimi do të fillojë me përfundimin e afatit kohorë të aplikimit

Aplikacionet e pranura pas përfundimit të afatit për dorëzim, nuk do të pranohen.

7.2 Vlerësimi i propozimeve

Vlerësimi i propozimeve do të bëhet nga një komision vlerësues me së paku 5 anëtarë, të cilët do të përfaqësojnë komunën e Prishtinës dhe institucionet relevante për zhvillim rural dhe zhvillim të bujqësisë, i cili do të vlerësojë të gjitha **aplikacionet të cilat do të kalojnë vlerësimin administrativ** përmes vizitave në teren. Vlerësimi i propozimeve do të bëhet konform rregullores për ndarjen e subvencioneve nga komuna e Prishtinës.

Me anë të dorëzimit të aplikimit në kuadër të kësaj thirrjeje, aplikanti pranon zbulimin e dokumenteve të paraqitura nga aplikuesi për vlerësuesit të emëruar nga komuna e Prishtinës, të cilët janë të përfshirë në proceset e vlerësimit dhe përzgjedhjes së propozimeve. Të gjitha aplikacionet e sukseshme apo të pasukseshme do të mbesin në arkivat e komunës e Prishtinës. **Aplikacionet e pasukseshme do të ruhen vetëm gjashtë (6) muaj pas përfundimit të vlerësimit, pastaj do të asgjësohen.**

Vlerësimi administrativ do të bëhet si më poshtë:

- **Nëse aplikacioni është dorëzuar pas afatit të caktuar, do të refuzohet automatikisht.**
- **Nëse aplikacioni i dorëzuar nuk është i nënshkruar nga aplikuesi, do të refuzohet automatikisht.**
- **Nëse aplikacioni nuk i plotëson të gjitha kriteret e pranueshmërisë dhe nëse ndonjë nga informacionet e kërkuara mungon ose është i pasaktë, aplikacioni mund të refuzohet vetëm në këtë bazë dhe aplikacioni nuk do të vlerësohet më tej.**



7.3 Kriteret e përzgjedhjes

Rezultati i aplikuesve do të jepet në bazë të kriterëve të mëposhtme:

LOT 1: Grantet për përmirësimin, rritjen apo diversifikimin e prodhimit primar bujqësor	
<u>Vlerësimi i aplikacioneve do të bëhet me pikë prej 1 deri në 5, sipas këtyre udhëzimeve:</u>	
<u>1 pikë</u>	<u>Shumë dobët</u>
<u>2 pikë</u>	<u>Dobët</u>
<u>3 pikë</u>	<u>Mirë</u>
<u>4 pikë</u>	<u>Shumë mirë</u>
<u>5 pikë</u>	<u>Shkëlqyeshëm</u>
Në LOT 1, vlerësimi maksimal është 60 pikë.	
Pjesa	Vlerësimi maksimal
Sa realist dhe i realizueshëm është veprimtaria e propozuar? A janë aktivitetet e realizueshme dhe konsistente në lidhje me rezultatet e pritura?	5 pikë
Cila është cilësia e strategjisë së paraqitur? Cili do të jetë kthimi i investimeve të propozuara në vitin e parë, të dytë dhe të tretë pas implementimit të projektit? Aplikacionet me kthim më të shpejtë të investimeve, do të vlerësohen me 5 pikë. Ndërsa aplikacionet me kthim të investimeve të paraqitura në mënyrë joreale, në këtë pjesë do të vlerësohen me 0 pikë.	5 pikë
Cili është kapaciteti i aplikuesit për të menaxhuar aktivitetin? Nëse aplikuesi ka të mbaruar shkollimin e mesëm për bujqësi, do të vlerësohet me 4 pikë. Nëse aplikuesi ka të mbaruar shkollimin e lartë për bujqësi, do të vlerësohet me 5 pikë. Nëse aplikuesi ka më shumë se 3 (tre) vite përvojë të dëshmuar në nën sektorin e caktuar për të cilin ka aplikuar, do të vlerësohet me 5 pikë.	5 pikë
Numri i vendeve të reja të punës të krijuara dhe qëndrueshmëria e tyre. Nëse numri i vendeve të reja të punës që parashihen të krijohen si rezultat i realizimit të projektit, vlerësohet si i përealizueshëm, aplikacioni në këtë pjesë do të vlerësohet me 0 pikë.	5 pikë
Si është paraqitur qëndrueshmëria e projektit të propozuar. Cili do të jetë kthimi i investimeve të propozuara në vitin e parë, të dytë dhe të tretë pas implementimit të projektit?	5 pikë



**Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Bujqësisë**

Cili është ndikimi i projektit të propozuar në menaxhimin dhe ruajtjen e mjedisit? Nëse propozimi do të ketë ndikim pozitiv të realizueshëm dhe të matshëm do të vlerësohet me 5 pikë.	5 pikë
Nëse propozimi është i paraqitur nga një aplikues femër, do të vlerësohet me 5 pikë. Nëse aplikuesi femër konfirmohet në vizitën në teren, aplikacioni në këtë pjesë do të vlerësohet me 5 pikë. Nëse aplikacioni është dorëzuar në emër të aplikuesit femër, ndërsa situata në teren nuk është e njejtë, në këtë pjesë aplikacioni do të vlerësohet me 0 pikë.	5 pikë
Aplikuesi apo ndonjë anëtar i familjes që jetojnë në një bashkësi familjare në dy vitet e fundit kanë përfituar grant nga komuna e Prishtinës ose donatorët e tjerë në Kosovë. Aplikuesit që nuk kanë përfituar do të vlerësohet me 5 pikë, ndërsa aplikuesit që kanë përfituar do të vlerësohen me 0 pikë. Aplikuesit që do të paraqesin informata të pasakta do të sanksionohen.	5 pikë
Pronësia e tokës, asetet e ndërlidhura me projektin e propozuar. Nëse toka ose prona e ndërlidhur me këtë propozim është në emër të aplikuesit, në këtë pjesë aplikacioni do të vlerësohet me 5 pikë. Nëse toka ose prona e ndërlidhur me këtë propozim, posedon kontratën e qirasë të noterizuar me periudhë minimale dhjetë vite pas datës së aplikimit, do të vlerësohet me 4 pikë.	5 pikë
Kosto e përshtatshme dhe e arsyeshme (të justifikueshme). Nëse aplikacioni paraqet kosto të pranueshme sipas këtij udhëzuesi dhe çmimet janë reale me çmimet e tregut, në këtë pjesë aplikacioni do të vlerësohet me 5 pikë. Nëse çmimet janë jo reale, në këtë pjesë do të vlerësohet me 0 pikë.	5 pikë
A përfshin projekti i propozuar teknika të reja (p.sh. teknikat inovative ose të marketingut). Cilat janë rezultatet e pritshme?	5 pikë
A synon projekti rritjen e kapacitetit ekonomik të fermerëve dhe përfshin një aktivitet të ri ekonomik në zonat rurale. Nëse propozimi do të ketë ndikim pozitiv të realizueshëm dhe të matshëm do të vlerësohet me 5 pikë.	5 pikë

LOT 2: Zgjerimin apo krijimin e kapaciteteve të ndërmarrjeve agro-ushqimore për përpunimin, ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore, si dhe promovimin e zinxhirit të vlerave bujqësore në komunën e Prishtinës.

Vlerësimi i aplikacioneve do të bëhet me pikë prej 1 deri në 5, sipas këtyre udhëzimeve:

<u>1 pikë</u>	<u>Shumë dobët</u>
<u>2 pikë</u>	<u>Dobët</u>
<u>3 pikë</u>	<u>Mirë</u>
<u>4 pikë</u>	<u>Shumë mirë</u>
<u>5 pikë</u>	<u>Shkëlqyeshëm</u>

Në LOT 2, vlerësimi maksimal është 60 pikë.

Pjesa	Vlerësimi maksimal
Sa realist dhe i realizueshëm është veprimtaria e propozuar? A janë aktivitetet e realizueshme dhe konsistente në lidhje me rezultatet e pritura?	5 pikë



Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Bujqësisë

<p>Cila është cilësia e strategjisë së paraqitur? Cili do të jetë kthimi i investimeve të propozuara në vitin e parë, të dytë dhe të tretë pas implementimit të projektit? Aplikacionet me kthim më të shpejtë të investimeve, do të vlerësohen me 5 pikë. Ndërsa aplikacionet me kthim të investimeve të paraqitura në mënyrë joreale, në këtë pjesë do të vlerësohen me 0 pikë.</p>	<p>5 pikë</p>
<p>Cili është kapaciteti i ndërrmarjes për të menaxhuar aktivitetin? Ndërrmarjet me më shumë se një vit përvojë të dëshmuar për përpunimin e produkteve bujqësore do të vlerësohen me 5 pikë. Ndërsa, aplikuesit me 1 vit përvojë të dëshmuar për përpunimin e produkteve bujqësore do të vlerësohen me 4 pikë. Ndërsa, aplikuesit me më pak se 1 vit përvojë pune, në këtë pjesë do të vlerësohen me 0 pikë.</p>	<p>5 pikë</p>
<p>Numri i vendeve të reja të punës të krijuara dhe qëndrueshmëria e tyre. Nëse numri i vendeve të reja të punës që parashihen të krijohen si rezultat i realizimit të projektit, vlerësohet si i perealizueshëm, aplikacioni në këtë pjesë do të vlerësohet me 0 pikë.</p>	<p>5 pikë</p>
<p>Si është paraqitur qëndrueshmëria e projektit të propozuar. Cili do të jetë kthimi i investimeve të propozuara në vitin e parë, të dytë dhe të tretë pas implementimit të projektit?</p>	<p>5 pikë</p>
<p>Cili është ndikimi i projektit të propozuar në menaxhimin dhe ruajtjen e mjedisit? Nëse propozimi do të ketë ndikim pozitiv të realizueshëm dhe të matshëm do të vlerësohet me 5 pikë.</p>	<p>5 pikë</p>
<p>Nëse propozimi është i paraqitur nga një aplikues femër, do të vlerësohet me 5 pikë. Nëse aplikuesi femër konfirmohet në vizitën në teren, aplikacioni në këtë pjesë do të vlerësohet me 5 pikë. Nëse aplikacioni është dorëzuar në emër të aplikuesit femër, ndërsa situata në teren nuk është e njejtë, në këtë pjesë aplikacioni do të vlerësohet me 0 pikë.</p>	<p>5 pikë</p>
<p>Aplikuesi apo ndonjë anëtar i familjes që jetojnë në një bashkësi familjare në dy vitet e fundit kanë përfituar grant nga komuna e Prishtinës ose donatorët e tjerë në Kosovë. Aplikuesit që nuk kanë përfituar do të vlerësohet me 5 pikë, ndërsa aplikuesit që kanë përfituar do të vlerësohen me 0 pikë. Aplikuesit që do të paraqesin informata të pasakta do të sanksionohen.</p>	<p>5 pikë</p>
<p>Pronësia e tokës, asetet e ndërlidhura me projektin e propozuar. Nëse toka ose prona e ndërlidhur me këtë propozim është në emër të aplikuesit, në këtë pjesë aplikacioni do të vlerësohet me 5 pikë. Nëse toka ose prona e ndërlidhur me këtë propozim, posedon kontratën e qirasë të noterizuar me periudhë minimale dhjetë vite pas datës së aplikimit, do të vlerësohet me 4 pikë.</p>	<p>5 pikë</p>
<p>Kosto e përshtatshme dhe e arsyeshme (të justifikueshme). Nëse aplikacioni paraqet kosto të pranueshme sipas këtij udhëzuesi dhe çmimet janë reale me çmimet e tregut, në këtë pjesë aplikacioni do të vlerësohet me 5 pikë. Nëse çmimet janë jo reale, në këtë pjesë do të vlerësohet me 0 pikë.</p>	<p>5 pikë</p>
<p>A synon projekt propozimi në rritjen e kapacitetit agro-ushqimor dhe a parashikon investime për zbatimin e standardeve të higjienës dhe sigurisë së</p>	<p>5 pikë</p>



**Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Bujqësisë**

ushqimit? Nëse po, në këtë pjesë projekti vlerësohet me 5 pikë. Nëse jo, në këtë pjesë, projekti vlerësohet me 0 pikë.	
A synon projekt propozimi në rritjen e kapacitetit përpunues agro-ushqimor dhe kontribuon në diversifikimin e prodhimit aktual të aplikantit dhe a do të çojë në kontrata të reja tregtare me fermerët për furnizimin e lëndëve të para? Nëse po, në këtë pjesë projekti vlerësohet me 5 pikë. Nëse jo, në këtë pjesë, projekti vlerësohet me 0 pikë.	5 pikë

LOT 3: Grante për zhvillimin e aktiviteteve rurale dhe diversifikimin e produkteve në fermat bujqësore në komunën e Prishtinës

Vlerësimi i aplikacioneve do të bëhet me pikë prej 1 deri në 5, sipas këtyre udhëzimeve:

<u>1 pikë</u>	<u>Shumë dobët</u>
<u>2 pikë</u>	<u>Dobët</u>
<u>3 pikë</u>	<u>Mirë</u>
<u>4 pikë</u>	<u>Shumë mirë</u>
<u>5 pikë</u>	<u>Shkëlqyeshëm</u>

Në LOT 3, vlerësimi maksimal është 60 pikë.

Pjesa	Vlerësimi maksimal
Sa realist dhe i realizueshëm është veprimtaria e propozuar? A janë aktivitetet e realizueshme dhe konsistente në lidhje me rezultatet e pritura?	5 pikë
Cila është cilësia e strategjisë së paraqitur? Cili do të jetë kthimi i investimeve të propozuara në vitin e parë, të dytë dhe të tretë pas implementimit të projektit? Aplikacionet me kthim më të shpejtë të investimeve, do të vlerësohen me 5 pikë. Ndërsa aplikacionet me kthim të investimeve të paraqitura në mënyrë joreale, në këtë pjesë do të vlerësohen me 0 pikë.	5 pikë
Cili është kapaciteti i aplikuesit për të menaxhuar aktivitetin? Nëse aplikuesi ka të mbaruar shkollimin e mesëm për bujqësi, do të vlerësohet me 4 pikë. Nëse aplikuesi ka të mbaruar shkollimin e lartë për bujqësi, do të vlerësohet me 5 pikë. Nëse aplikuesi ka më shumë se 3 (tre) vite përvojë të dëshmuar në nën sektorin e caktuar për të cilin ka aplikuar, do të vlerësohet me 5 pikë.	5 pikë
Numri i vendeve të reja të punës të krijuara dhe qëndrueshmëria e tyre. Nëse numri i vendeve të reja të punës që parashihen të krijohen si rezultat i realizimit të projektit, vlerësohet si i përealizueshëm, aplikacioni në këtë pjesë do të vlerësohet me 0 pikë.	5 pikë
Si është paraqitur qëndrueshmëria e projektit të propozuar. Cili do të jetë kthimi i investimeve të propozuara në vitin e parë, të dytë dhe të tretë pas implementimit të projektit?	5 pikë



**Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Bujqësisë**

Cili është ndikimi i projektit të propozuar në menaxhimin dhe ruajtjen e mjedisit? Nëse propozimi do të ketë ndikim pozitiv të realizueshëm dhe të matshëm do të vlerësohet me 5 pikë.	5 pikë
Nëse propozimi është i paraqitur nga një aplikues femër, do të vlerësohet me 5 pikë. Nëse aplikuesi femër konfirmohet në vizitën në teren, aplikacioni në këtë pjesë do të vlerësohet me 5 pikë. Nëse aplikacioni është dorëzuar në emër të aplikuesit femër, ndërsa situata në teren nuk është e njëjtë, në këtë pjesë aplikacioni do të vlerësohet me 0 pikë.	5 pikë
Aplikuesi apo ndonjë anëtar i familjes që jetojnë në një bashkësi familjare në tre vitet e fundit kanë përfituar grant nga komuna e Prishtinës ose donatorët e tjerë në Kosovë. Aplikuesit që nuk kanë përfituar do të vlerësohet me 5 pikë, ndërsa aplikuesit që kanë përfituar do të vlerësohen me 0 pikë. Aplikuesit që do të paraqesin informata të pasakta do të sanksionohen.	5 pikë
Pronësia e tokës, asetet e ndërlidhura me projektin e propozuar. Nëse toka ose prona e ndërlidhur me këtë propozim është në emër të aplikuesit, në këtë pjesë aplikacioni do të vlerësohet me 5 pikë. Nëse toka ose prona e ndërlidhur me këtë propozim, posedon kontratën e qirasë të noterizuar me periudhë minimale dhjetë vite pas datës së aplikimit, do të vlerësohet me 4 pikë.	5 pikë
Kosto e përshtatshme dhe e arsyeshme (të justifikueshme). Nëse aplikacioni paraqet kosto të pranueshme sipas këtij udhëzuesi dhe çmimet janë reale me çmimet e tregut, në këtë pjesë aplikacioni do të vlerësohet me 5 pikë. Nëse çmimet janë jo reale, në këtë pjesë do të vlerësohet me 0 pikë.	5 pikë
A përfshin projekti i propozuar teknika të reja (p.sh. teknikat inovative ose të marketingut). Cilat janë rezultatet e pritshme?	5 pikë
A synon projekti rritjen e kapacitetit ekonomik të fermerëve dhe përfshin një aktivitet të ri ekonomik në zonat rurale. Nëse propozimi do të ketë ndikim pozitiv të realizueshëm dhe të matshëm do të vlerësohet me 5 pikë.	5 pikë

7.4 Ku dhe si të dërgohen formularët

Zarfi i jashtëm i aplikacionit duhet të përmbajë titullin e thirrjes për propozime " Thirrja për propozime për zhvillim rural dhe zhvillim të bujqësisë në komunën e Prishtinës . Poashtu duhet të specifikohet Lot1 , Lot 2 ose Lot 3, varësisht nga fusha e projektit të propozuar.

Kërkohet nga aplikuesit të dorëzojnë një propozim origjinal në një zarf të mbyllur të formatit A4 i cili shënohet me "Aplikacioni Teknik".

Propozimi duhet të dorëzohet përmes postës se regjistruar ose të dorëzohet fizikisht në Drejtorinë e Bujqësisë, në adresën e mëposhtme:

- Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna e Prishtinës, Rr. UÇK-2-10000, Prishtinë, Kosovë.



8. Menaxhimi i grantit:

Pasi të përfundojë procesi i vlerësimit, komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Bujqësisë do të kërkojë nga përfituesit e para-përzgjedhur të granteve që të ofrojnë të paktën tri oferta të marra nga shitësit e ndryshëm, që nuk janë në lidhje familjare me aplikuesit, për pajisjet e nevojshme ose shërbimet e parashikuara nga projekt propozimet.

Ekipi i komunës së Prishtinës, përkatësisht Drejtorisë së Bujqësisë do të mbledhë dhe kontrollojë ofertat, për të verifikuar nëse ato pasqyrojnë çmimin e vërtetë të tregut. **Nëse ofertat e mbledhura nga komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Bujqësisë janë më shumë se 5% më të lira se sa ofertat e ofruara nga aplikuesi - aplikuesi nuk do të jetë i pranueshëm për çfarëdo financimi të mëtejshëm nga komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Bujqësisë.**

Pas përfundimit të përzgjedhjes, marrëveshjet e nën-kontraktimit do të nënshkruhen me secilin përfitues të përzgjedhur, mes tyre dhe komunës së Prishtinës. Në marrëveshjen e nën-grantit, projekti pret rezultate dhe tregues të matshëm që do të përcaktohet dhe dakordohen me përfituesin. Kontributi/pjesëmarrja financiare e aplikuesit duhet të investohet në fazën e parë të realizimit të projektit. Kjo duhet të dëshmohet me fatura origjinale, transfertat bankare të bëra që korrespondojnë me faturat me furnizuesit/kontraktorët dhe me listën e garancionit për pajisjet e reja. Investimet e bëra duhet të inspektohen nga ekipi i caktuar nga komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtorisë së Bujqësisë.

Kontributi/pjesëmarrja financiare e aplikuesit duhet të realizohet brenda 60 ditëve pas nënshkrimit të kontratës me **komunën e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Bujqësisë.**

Përfituesit e përzgjedhur nuk do t'i ofrohet asnjë parapagim nga ana e komunës së Prishtinës. Pagesat do të bëhen në bazë të parimit të rimbursimit. Ekipi i caktuar i **komunës së Prishtinës, përkatësisht Drejtorisë së Bujqësisë**, do të kryejë inspektim apo vizita monitoruese, për të verifikuar nëse rezultatet e projektit janë realizuar në përputhje me kontratat dhe faturat e nënshkruara dhe të dorëzuara nga përfituesit, të cilat do të lejojnë apo nuk do të lejojnë lëshimin e kësteve për aplikuesit e përzgjedhur. Përveç kësaj, përfituesit e grantit do të duhet të ofrojnë fatura të rregullta dhe dëshmi të pagesave në përputhje me legjislacionin në Kosovë.

Investimet e bëra nga Komuna e Prishtinës duhet të ruhen dhe nuk mund të tjetërsohen për një periudhë minimale prej 7 viteve, pas realizimit të projektit, në të kundërtën komuna e Prishtinës është e detyruar të marr masa ligjore. Monitorimi dhe vlerësimi (M&V) do të zhvillohet rregullisht nga komuna e Prishtinës.